



*Republika e Kosovës*  
*Republika Kosova-Republic of Kosovo*  
*Qeveria - Vlada - Government*

**RREGULLORE (QRK) NR.34/2024 PËR PERFORMANCË RAJONALE  
DHE MONITORIM TË ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK RAJONAL  
TË BALANCUAR<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Rregullore (QRK) Nr.34/2024 për Performancë Rajonale dhe Monitorim të Zhvillimit Socio - Ekonomik Rajonal të Balancuar, është miratuar në mbledhjen e 230-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 03/230, të datës 13.11.2024.

## **Qeveria e Republikës së Kosovës**

Në mbështetje të nenit 94 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19, paragrafit 1.4, të Ligjit Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/7 gusht 2023), nenit 8 paragrafi 4 (4.5), të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës si dhe bazuar në Rregulloren Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16 Gusht 2023).

### **Miraton:**

## **RREGULLORE (QRK) NR.34/2024 PËR PERFORMANCË RAJONALE DHE MONITORIM TË ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR**

### **KAPITULLI I**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë fushat, kriteret dhe treguesit për vlerësimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar dhe të ofrojë rekomandime për përmirësimin e procesit të zhvillimit rajonal.
2. Kjo rregullore është në përputhje me Rregulloret e BE-së 1299/2013 dhe 1303/2013.

##### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo Rregullore përfshin hartimin dhe zbatimin e metodologjisë dhe kriterëve për vlerësimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar, identifikimin dhe përcaktimin e fushave të rëndësishme dhe përdorimin e tyre për monitorimin e performancës së rajoneve zhvillimore. Gjithashtu, përfshin analizën e të dhënave të mbledhura, interpretimin e rezultateve dhe hartimin e rekomandimeve për të përmirësuar zhvillimin rajonal.

##### **Neni 3**

##### **Përkufizimet**

Shprehjet, termet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin e njëjtë siç janë në Ligjin përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar, shprehjet shtesë të përdorura kanë këtë kuptim:

1. **Performancë rajonale** – nënkupton vlerësimin e përparimit dhe efikasitetit të zhvillimit rajonal dhe rritjes së zhvillimit ekonomik në një rajon zhvillimor të caktuar, si niveli i

punësimit, cilësia e jetës dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm për performancën e rajoneve zhvillimore.

2. **Mesatarja** – është vlera e përgjithshme e një grupi të të dhënave numerike të një treguesi të caktuar që llogaritet duke i mbledhur të gjitha vlerat dhe pastaj pjesëtohen me numrin e atyre vlerave.

3. **Mediana** – është vlera e mesme e një grupi të dhënash numerike të një treguesi të caktuar në kuadër të treguesve, duke i renditur të dhënat nga numri më i vogël tek më i madhi dhe anasjelltas.

#### **Neni 4**

### **Parimet e Zhvillimit Rajonal të Balancuar**

Gjatë matjes së Performancës Rajonale dhe Monitorimit të Zhvillimit Socio – Ekonomik Rajonal të Balancuar zbatohen parimet e përcaktuara me Ligjin përkatës për Zhvillim Rajonal të Balancuar.

#### **Neni 5**

### **Politikat e përfshirjes Socio – Ekonomike**

1. Politikat e përfshirjes socio – ekonomike janë pjesë e strategjive dhe masave që adresojnë sfidat, përforcojnë zhvillimin rajonal të balancuar dhe synojnë të përfshijnë të gjitha grupet shoqërore në zhvillimin socio - ekonomik. Këto politika ndikojnë në rritjen e nivelit të punësimit, përmirësimin në arsim dhe shëndetësi dhe ndihmojnë në krijim e një ambienti të favorshëm për zhvillim socio – ekonomik të rajonit zhvillimor, përmes matjeve në:

- 1.1. Investime në infrastrukturë;
- 1.2. Politika e arsimit dhe ngritja e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- 1.3. Stimulimi i ndërmarrësisë dhe zhvillimi i biznesit;
- 1.4. Politika e punësimit;
- 1.5. Politika e mirëqenies sociale.

#### **Neni 6**

### **Objektivat e Përgjithshme**

1. Objektivat e përgjithshme me ndikim në përmirësimin e performancës socio-ekonomike në nivelin e rajonit zhvillimor, janë me sa vijon:

1.1. Rritja e zhvillimit ekonomik, me qëllim të stimulimit të rritjes ekonomike në të gjitha rajonet zhvillimore, duke përdorur mjete dhe politika të përshtatshme për të përmirësuar produktivitetin dhe konkurrues mërinë;

1.2. Përmirësimi i përfshirjes sociale, me qëllim të promovimit të përfshirjes sociale, duke adresuar pabarazitë dhe duke siguruar që të gjitha grupet shoqërore të përfitojnë nga zhvillimi rajonal;

1.3. Ndihma për grupet e marginalizuara, me qëllim të adresimit të nevojave specifike të grupeve të marginalizuara, përmes politikave dhe masave që përmirësojnë kushtet e tyre socio – ekonomike;

1.4. Promovimi i edukimit, aktiviteteve arsimore, kulturore, rinore dhe sportive me qëllim të rritjes së qasjes dhe cilësisë, duke përfshirë trajnimet dhe programet e nevojshme për forcimin e burimeve njerëzore në nivel të rajonit zhvillimor;

1.5. Zhvillimi i infrastrukturës, me qëllim të investimeve në infrastrukturë për të përmirësuar kushtet e infrastrukturës së transportit, energjisë, teknologjisë në rajonet zhvillimore dhe sektorët tjerë;

1.6. Përdorimi i kujdesshëm i burimeve natyrore, me qëllim të promovimit të një zhvillimi të qëndrueshëm, duke adresuar çështjet e mjedisit;

1.7. Monitorimi dhe raportimi i rezultateve, me qëllim të sigurimit të një sistemi të përhershëm, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie në zbatimin e rregullores.

## **Neni 7**

### **Fushat, Kriteret dhe Treguesit e Performancës**

1. Fushat e performancës përfshijnë fushat themelore të analizës së performancës së rajoneve zhvillimore, kriteret përdoren për të vlerësuar këtë performancë ndërsa treguesit shërbejnë si mjet për monitorimin dhe vlerësimin e performancës rajonale.

2. Shqyrtimi i fushave, kriterëve dhe treguesve të performancës në mënyrë të ndarë, ofron një pasqyrë të saktë për gjitha fushat, kriteret dhe treguesit të cilët përdoren për të vlerësuar zhvillimin socio – ekonomik të rajonit zhvillimor dhe mundësojnë të kuptuarit e ndryshimeve dhe trendet e zhvillimit të performancës socio – ekonomike në një rajon zhvillimor të caktuar.

3. Ministria rezervon të drejtën që të caktojë fushat prioritare dhe periudhat kohore për matjen e performancës rajonale.

## **Neni 8**

### **Fushat e zbatimit për matjen e performancës**

1. Fushat e zbatimit përfshijnë të dhëna kyçe dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e zhvillimit socio – ekonomik në rajonin zhvillimor. Fushat të cilat do të analizohen dhe monitorohen në zbatim të kësaj rregullore por që nuk janë të kufizuara, janë:

1.1. Demografia;

- 1.2. Shëndetësia;
- 1.3. Punësimi, varfëria dhe asistenca sociale;
- 1.4. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti;
- 1.5. Zhvillimi ekonomik;
- 1.6. Bizneset;
- 1.7. Tregtia;
- 1.8. Bujqësia;
- 1.9. Industria, xehetaria dhe minierat;
- 1.10. Infrastruktura;
- 1.11. Projektet kapitale;
- 1.12. Turizmi.

## **Neni 9**

### **Kriteret dhe Treguesit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik në rajonin zhvillimor**

1. Kriteret për vlerësimin e performancës përbëjnë një aspekt të rëndësishëm i cili ndihmon në vlerësimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar.
2. Treguesit për monitorimin e zhvillimit socio – ekonomik në rajonin zhvillimor janë të dhëna specifike të cilat përdoren për të matur, përshkruar dhe vlerësuar performancën në një kontekst të caktuar.
3. Kriteret dhe Treguesit për matjen e performancës përfshijnë të dhënat, por që nuk janë të kufizuara, sipas fushave si në vijim:
  - 3.1. Demografia – përfshinë kriteret dhe treguesit: numrin e përgjithshëm të popullsisë, lëvizjet e popullsisë, numrin e lindjeve dhe vdekjeve, struktura e popullsisë sipas grupëmoshave dhe gjinisë, dendësinë e popullsisë;
  - 3.2. Shëndetësia – përfshinë kriteret dhe treguesit: infrastrukturën shëndetësore, burimet njerëzore;
  - 3.3. Punësimi, varfëria dhe asistenca sociale – përfshin kriteret dhe treguesit: të dhëna të lidhura me shkallën e papunësisë dhe punësimin, niveli i pagave, shkalla e varfërisë, niveli i ndihmës sociale;
  - 3.4. Arsimi, kultura, rinia dhe sporti – përfshinë kriteret dhe treguesit: infrastrukturën arsimore, kulturore dhe sportive, burimet njerëzore, numrin e nxënësve/studentëve sipas niveleve, aktivitetet kulturore dhe sportive;
  - 3.5. Zhvillimi ekonomik – përfshinë kriteret dhe treguesit: rritjen ekonomike shkallën e investimeve, niveli i investimeve të huaja, krijimin e vendeve të reja të punës;

3.6. Bizneset – përfshinë kriteret dhe treguesit: numrin e kompanive të regjistruara, shkalla e rritjes së numrit të bizneseve të vogla dhe të mesme, kontributi në tregun e punës dhe rritja ekonomike;

3.7. Tregtia – përfshinë kriteret dhe treguesit: të dhëna të lidhura me vlerën e importit dhe eksportit të mallrave;

3.8. Bujqësia – përfshinë kriteret dhe treguesit: sipërfaqen e tokës bujqësore, produktivitetin bujqësor, përqindjen e punëtoreve në sektorin bujqësor, kontributi në bruto produkti vendor;

3.9. Industria, xehetaria dhe minierat – përfshinë kriteret dhe treguesit: lidhur me prodhimin industrial, investimet në sektorin industrial, numri i punëtorëve në sektorin industrial, nivelin e zhvillimit të infrastrukturës së xehetarisë dhe minierave;

3.10. Infrastruktura – përfshinë kriteret dhe treguesit: investimet në infrastrukturë ndikimi i investimeve në infrastrukturë në rritje të zhvillimit socio - ekonomik;

3.11. Projektet kapitale – përfshinë kriteret dhe treguesit: numrin dhe vlerën e investimeve kapitale, impakti i projekteve në zhvillimin socio – ekonomik;

3.12. Turizmi – përfshinë kriteret dhe treguesit: numrin e vizitorëve, identifikimi i zonave turistike, shkalla e rritjes së zhvillimit të turizmit, kontributi në bruto produktin vendor, niveli i zhvillimit të infrastrukturës turistike, numri i të punësuarve në sektorin e turizmit.

## **KAPITULLI II**

### **ANALIZA DHE RAPORTIMI I PERFORMANCËS RAJONALE PËR ZHVILLIM SOCIO – EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR**

#### **Neni 10**

##### **Synimi dhe rëndësia e analizës së zhvillimit rajonal dhe raportimit të performancës**

1. MZHR synon të realizojë analizë të thellë dhe objektive të performancës rajonale në aspektin socio – ekonomik, të sigurojë një pasqyrë të plotë të rajonit zhvillimor duke përfshirë fushat kryesore për një rajon zhvillimor.

2. Nëpërmjet analizës së fushave të performancës, synohet të identifikohen sfidat, mundësitë dhe potencialet për rritjen dhe përmirësimin e situatës socio - ekonomike në nivel të rajonit zhvillimor. Për këtë qëllim përdoren metoda dhe teknika të specializuara për të vlerësuar dhe monitoruar performancën rajonale.

3. Raportimi i rezultateve është i strukturuar dhe i përpiktë për të ndihmuar në hartimin e politikave dhe strategjive për rajonin zhvillimor. Analiza dhe raportimi synon të jetë një mjet efektiv për vendimmarrje dhe planifikim të rajonit zhvillimor në mënyrë të qëndrueshme dhe të balancuar.

## **Neni 11**

### **Metodat për monitorimin dhe rishikimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomik të rajonit zhvillimor**

1. Metodat dhe teknikat e përdorura për monitorimin dhe rishikimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomike të rajonit zhvillimor, trajtojnë metodat statistikore, teknikat e analizës së të dhënave si dhe mënyrën e vlerësimit të trendeve dhe ndryshimeve në rajonin zhvillimor.

2. Për realizimin e synimit dhe ofrimit të një përmbledhje të qartë të procesit të monitorimit dhe rishikimit të performancës në rajonin zhvillimor, përdoren metodat si në vijim:

2.1. metoda e analizës statistikore deskriptive, përfshin përdorimin e statistikave për të përshkruar të dhënat në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në kuadër të kësaj metode përfshihen të dhënat statistikore si mesatarja dhe mediana, si dhe paraqitja grafike e të dhënave;

2.2. metoda e analizës së regresionit, është metodë statistikore që përdoret për të studiuar dhe për të përshkruar marrëdhëniet midis dy e më shumë treguesve;

2.3. metoda e analizës së periudhës kohore, përdoret për të studiuar ndryshimet në një seri të dhënash si në rritje ekonomike, zvogëlimi i papunësisë, ndryshimet demografike dhe të tjera, për një periudhë të caktuar kohore, ku përfshin identifikimin e modeleve dhe ndryshimeve, si dhe përdorimin e teknikave për parashikimin e vlerave dhe perudhave të ardhshme kohore;

2.4. metoda e analizës së tërësisë së të dhënave, përfshin burimet e të dhënave, përmbajtjen e të dhënave, format e të dhënave, privatësia dhe siguria e të dhënave, disponueshmëria dhe qasja në të dhëna. Kjo metodë përdoret për të analizuar modelet dhe ndryshimet që ndodhen brenda të dhënave komplekse, duke përdorur mjetet dhe teknologjitë për analizën e të dhënave.

## **Neni 12**

### **Validimi dhe transparenca e analizës**

1. Për të garantuar saktësinë dhe besueshmërinë e analizës së performancës rajonale, është i rëndësishëm procesi i strukturuar për sigurimin e rezultateve dhe transparencës në gjithë procesin. Këtu përfshihet verifikimi i të dhënave të përdorura për analizë, vlerësimi i metodologjisë dhe sigurimi që gjithë të interesuarit të kenë qasje në të dhënat dhe metodat e përdorura.

2. Ky proces siguron që analiza është e saktë, e besueshme dhe shërben si bazë për të marrë vendime për zhvillimin e politikave në nivel rajonal.

3. Metodat e validimit, na sigurojnë që rezultatet e analizës janë të sakta dhe të besueshme, si në vijim:

3.1. verifikimi i të dhënave siguron që të dhënat janë të sakta, të plota dhe të përshtatshme për qëllimin e analizës;

3.2. vlerësimi i metodologjisë ndihmon në përcaktimin dhe vlerësimin e metodave statistikore dhe teknikave për analizën e të dhënave, 3.3. përsëritja e analizës përfshinë realizimin e analizës nga një cikël kontrollesh të ndryshme brenda institucionit përgjegjës për të konfirmuar rezultatet dhe për të identifikuar ndonjë gabim gjatë hartimit të analizës;

3.3. verifikimi i rezultateve përfshinë kontrollin e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve nga burime të ndryshme dhe verifikimin e tyre përmes metodave alternative për të siguruar që rezultatet janë të përputhshme dhe të besueshme;

### **Neni 13**

#### **Mbledhja e të dhënave**

1. MZHR kujdeset për krijimin, funksionalizimin dhe avancimin e mekanizmave për mbledhjen e të dhënave nga ministritë e linjës, rajonet zhvillimore, Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe akterët tjerë relevant, sipas objektivave në nenin 6 të kësaj rregullore, si dhe për raportimin periodik të rezultateve, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

2. Mbledhja e të dhënave për analiza, realizohet përmes sistemit elektronik dhe formave tjera zyrtare.

### **Neni 14**

#### **Përpunimi dhe përditësimi i të dhënave**

1. Përpunimi dhe përditësimi i të dhënave janë dy procese kyçe në menaxhimin dhe monitorimin e informatave të mbledhura. Përpunimi i të dhënave përfshin mbledhjen, analizën dhe interpretimin e tyre për të nxjerrë përfundime të rëndësishme dhe për të ndërmarrë vendime të bazuara të analizës, ndërsa përditësimi i të dhënave është proces i rifreskimit dhe plotësim ndryshimit të të dhënave në një bazë të dhënash për të siguruar që informatat janë të qasshme dhe të sakta.

### **Neni 15**

#### **Analiza e performances së zhvillimit socio – ekonomik në rajonin zhvillimor të balancuar**

1. Analiza e performances së zhvillimit socio – ekonomik në rajonin zhvillimor të balancuar, adreson nevojën për të kuptuar se si ndryshimet dhe progresi në nivel rajonal mund të vlerësohen dhe analizohen për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe të barabartë në shtatë (7) rajonet zhvillimore.

2. Analiza e performancës përfshinë vlerësimin e treguesve dhe ndryshimeve kryesore socio – ekonomike në nivel rajonal, identifikimin e sfidave dhe përcaktimin e ndikimit të politikave dhe masave të ndërmarra, për të siguruar bazë të qëndrueshme në hartimin e strategjive të zhvillimit rajonal të balancuar, sipas nevojës.



3. Përmes analizës së performancës së zhvillimit rajonal, mund të identifikohen zonat ne rajonet zhvillimore me zhvillim të konsiderueshëm dhe ato me potencial për të ardhmen.

4. Informacionet dhe rezultatet e analizave, ndihmojnë autoritetet qendrore dhe lokale në hartimin e politikave dhe masave të përshtatshme për të ndihmuar në rritjen e performancës rajonale dhe në përmirësimin e kushteve socio – ekonomike të popullsisë.

## **Neni 16**

### **Formula për matjen e performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal të balancuar**

1. Në këtë rregullore, janë përcaktuar tri indekse kyçe për të vlerësuar zhvillimin rajonal të balancuar të cilat përdoren për të vlerësuar të arriturat e zhvillimit rajonal në mënyrë të qëndrueshme dhe të përafërt, si në vijim:

1.1. Indeksi socio – ekonomik;

1.2. Indeksi demografik, bazohet në indikatorët kryesorë dhe

1.3. Indeksi i zhvillimit.

#### **1.1.1. Indeksi socio – ekonomik, përfshin katër indikatorë kryesorë:**

1.1.1.1. prodhimi i brendshëm bruto për kokë banori sipas rajoneve zhvillimore

1.1.1.2. të ardhurat buxhetore për kokë banori

1.1.1.3. rritja e vlerës së shtuar të sektorit jo-financiar dhe

1.1.1.4. shkalla e papunësisë.

#### **1.1.2. Formula e indeksit socio – ekonomik:**

1.1.2.1. për indikatorin e prodhimit të brendshëm bruto për kokë banori sipas rajoneve zhvillimore përcaktohet koeficienti 0.3, i cili tregon prodhimi i brendshëm bruto ka një peshë prej 30% në indeks.

1.1.2.2. për indikatorin e të ardhurave buxhetore për kokë banori përcaktohet koeficienti 0.2, i cili tregon se të ardhurat buxhetore kanë një peshë prej 20% në indeks.

1.1.2.3. për rritjen e vlerës së shtuar përcaktohet koeficienti 0.3, i cili tregon se rritja e vlerës së shtuar të sektorit jo-financiar ka një peshë prej 30% në indeks.

1.1.2.4. për shkallën e papunësisë përcaktohet koeficienti 0.2, i cili tregon se shkalla e papunësisë ka një peshë prej 20% në indeks;

#### **1.2.1. Indeksi demografik, bazohet në indikatorët kryesorë:**

1.2.1.1. rritjen natyrore;

1.2.1.2. indeksin e plakjes;

- 1.2.1.3. bilancin e migrimeve për një mijë (1000) banorë dhe
- 1.2.1.4. numrin e studentëve të diplomuar për një mijë (1000) banorë.

### **1.2.2. Formula e indeksit demografik:**

- 1.2.2.1. për indeksin e rritjes natyrore përcaktohet koeficienti 0.25, i cili tregon se rritja natyrore ka një peshë prej 25% në indeks.
- 1.2.2.2. për indeksin e plakjes përcaktohet koeficienti 0.2, i cili tregon se plakja ka një peshë prej 20% në indeks.
- 1.2.2.3. në indeksin për bilancin e migrimeve për një mijë (1000) banorë përcaktohet koeficienti 0.3, i cili tregon se bilanci i migrimeve për një mijë (1000) banorë ka peshë prej 30% në indeks.
- 1.2.2.4. për indeksin e studentëve të diplomuar për një mijë (1000) banorë përcaktohet koeficienti 0.25, i cili tregon se studentët e diplomuar për një mijë (1000) banorë ka peshë prej 25% në indeks.

### **1.3.1. Indeksi i zhvillimit:**

- 1.3.1.1. kombinon mesataren e zhvillimit socio – ekonomik dhe
- 1.3.1.2. indeksin demografik për të reflektuar performancën e përgjithshme të zhvillimit të një rajoni.

### **1.3.2. Formula e indeksit të zhvillimit:**

- 1.3.2.1. në një rajon zhvillimor, nëse mesatarja e koeficientit për indeksin e zhvillimit socio-ekonomik përcaktohet 0.40, tregon se zhvillimi socio – ekonomik ka peshë prej 40% të indeksit, dhe
- 1.3.2.2. nëse koeficienti demografik klasifikohet 0.60, tregon se indeksi demografik ka peshën 60% të indeksit.

## **Neni 17**

### **Interpretimi dhe raportimi i rezultateve**

1. Interpretimi dhe raportimi i rezultateve, përfshin analizën dhe interpretimin e të dhënave të mbledhura për të nxjerr përfundime dhe rekomandime të rëndësishme për zhvillimin socio – ekonomik në rajonin zhvillimor.
2. Paraqitja e metodave dhe teknikave të përdorura për analizën e të dhënave si dhe mënyra e raportimit të rezultateve me qëllim të përcjelljes së informacioneve në një mënyrë të qartë dhe efektive, janë me rëndësi të theksuar për të interesuarit dhe përdoruesit e kësaj rregullore.

## **Neni 18**

### **Burimet e financimit**

1. Kjo Rregullore përcakton performancën e zhvillimit socio – ekonomik rajonal nga burimet e financimit të nivelit qendror, niveli lokal, donatorët si dhe burime tjera të financimit:

1.1. investimet nga niveli qendror dhe lokal të cilat përfshijnë investimet në rregullimin e infrastrukturës, investime në arsim, shëndetësi, bujqësi, turizëm, zhvillim social dhe të tjera;

1.2. investimet nga donatorët të jashtëm të cilat përfshijnë projekte dhe fonde nga organizatat ndërkombëtare dhe bashkëfinancues ndërinstitucional të brendshëm;

1.3. burimet tjera të financimit të cilat mund të jenë nga sektori privat, fondacione dhe organizata joqeveritare.

## **Neni 19**

### **Parametrat e vlerësimit të performances rajonale**

1. Parametrat për vlerësimin e performancës rajonale përcaktojnë standardet dhe kriteret për matjen dhe vlerësimin e performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal. Këto parametra përfshijnë aspekte të ndryshme të jetës socio – ekonomike, sipas kriterëve të parapara në nenin 9 të kësaj rregullore.

2. Parametrat e vlerësimit të performancës së zhvillimit socio – ekonomik rajonal, përfshijnë këto aspekte kyçe:

2.1. efikasiteti financiar, përfshin menaxhimin efektiv të burimeve financiare të një rajoni, për të arritur qëllimin e zhvillimit rajonal, vlerësimin e performancës së shfrytëzimit të buxhetit publik dhe përdorimit të fondeve për shërbime publike;

2.2. ndikimi në zhvillimin rajonal, përcakton efektin dhe ndryshimet që politikat e investimeve dhe masat e ndërmarra në nivelin e përgjithshëm kanë dhënë rezultate në zhvillimin socio – ekonomik të një rajoni. Ky parametër analizon rezultatet e ndërhyrjeve specifike në rritjen ekonomike, nivelin e arsimit, infrastrukturës dhe faktorët tjerë që ndikojnë në zhvillimin rajonal.

## KAPITULLI III

### DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR PERFORMANCË RAJONALE DHE MONITORIM TË ZHVILLIMIT SOCIO - EKONOMIK RAJONAL TË BALANCUAR

#### Neni 20

#### Përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal

1. Përgjegjësitë e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për Performancë Rajonale dhe Monitorim të Zhvillimit Socio - Ekonomik Rajonal të Balancuar, janë si në vijim:

1.1. është përgjegjëse për koordinimin e hartimit dhe zbatimit të politikave për zhvillim rajonal të balancuar;

1.2. monitoron dhe vlerëson performancën rajonale në përputhje me kriteret dhe standardet e përcaktuara;

1.3. përgatit dhe prezanton raporte mbi zhvillimin socio – ekonomik të rajoneve zhvillimore;

1.4. koordinon dhe bashkëpunon me autoritetet qendrore dhe lokale, agjencitë dhe Qendrat për Zhvillim Rajonal;

1.5. identifikon dhe adreson sfidat dhe problemet e specifikuar në rajone për të përmirësuar performancën rajonale;

1.6. promovon bashkëpunimin me akterët relevant për të përcaktuar prioritetet dhe veprimet e nevojshme për zhvillim rajonal;

1.7. siguron resurset dhe kapacitetet e nevojshme për zbatimin e rregullores dhe për mbështetjen e projekteve të zhvillimit rajonal;

1.8. vlerëson efektivitetin dhe impaktin e politikave dhe masave të ndërmarra për zhvillimin rajonal;

1.9. komunikon dhe sensibilizon komunitetin për përmirësimin e politikave dhe veprimeve për zhvillimin rajonal;

1.10. krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave të zhvillimit rajonal të balancuar.

## **Neni 21**

### **Përgjegjësitë e Qendrave për Zhvillim Rajonal**

1. Përgjegjësitë e Qendrave për Zhvillim Rajonal për performancë rajonale dhe monitorim të zhvillimit Socio - Ekonomik rajonal të balancuar, janë si në vijim:

- 1.1. koordinimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive për zhvillim rajonal në nivelin lokal;
- 1.2. përgaditjen dhe prezantimin e raporteve mbi progresin e zhvillimit të rajonit;
- 1.3. identifikimin dhe analizën e sfidave dhe mundësive të zhvillimit në nivel lokal;
- 1.4. bashkëpunimin me institucionet qendrore, lokale, organizatat joqeveritare dhe sektorin privat për zhvillimin e rajonit;
- 1.5. koordinimin e projekteve dhe iniciativave, sipas kriterëve të performancës, të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregullore;
- 1.6. sigurimin e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së rajonit;
- 1.7. promovimin e bashkëpunimit dhe koordinimit mes të gjithë akterëve të interesuar për zhvillimin e rajonit;
- 1.8. ndërmarrjen e veprimeve për adresimin e çështjeve dhe sfidave emergjente që shfaqen në rajonin e tyre të përgjegjësisë;
- 1.9. komunikimin e politikave dhe masave për zhvillimin rajonal ndaj komunitetit lokal dhe të interesuarve tjerë.

**KAPITULLI IV**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 22**  
**Zbatimi**

Kjo Rregullore zbatohet nga Ministria për Zhvillim Rajonal, në bashkëpunim dhe koordinim me institucionet qendrore dhe lokale, agjencitë dhe Qendrat për Zhvillim Rajonal.

**Neni 23**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin Kurti**

\_\_\_\_\_  
**Kryeministër i Republikës së Kosovës**

**Datë: 20/11/2024**